PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Broshurë 3 mujori i Tretë
Korrik – Shtator 2026



Përgjegjësia Sociale e Korporatave (CSR) reflekton angazhimin e sektorit bankar për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, përtej veprimtarisë së përditshme. Përmes mbështetjes së nismave në komunitet, bankat luajnë një rol aktiv në përmirësimin e mirëqenies sociale, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjatë periudhës korrik - shtator 2026, bankat vijuan të investojnë në projekte dhe iniciativa që adresojnë nevoja konkrete të komunitetit, nga edukimi, shëndeti dhe përfshirja sociale, te mbrojtja e mjedisit, kultura dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Këto iniciativa pasqyrojnë një qasje afatgjatë ndaj përgjegjësisë korporative, të bazuar në partneritete me institucione publike, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, me synim krijimin e ndikimit pozitiv dhe të matshëm për komunitetin dhe ekonominë shqiptare.



abi AMERICAN BANK OF INVESTMENTS
BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE
CREDINS BANK
Fibank First Investment Bank
Jet.bank
INTESA SANPAOLO BANK Albania
otpbank
ProCredit Bank
Raiffeisen Bank
TIRANA BANK
UnionBank
UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë

DIMENSIONI I MJEDISIT

JET BANK:

- Shmang rreth 100,000 kilometra udhëtime me automjet në vit, sipas një skenari referues për 12 muaj aktivitet bankar me 10,000 klientë, duke mundësuar kursimin e rreth 6,500 litrave karburant dhe shmangien e 15.3 tonëve CO_2, si dhe reduktimin e emetimeve të ndotësve të tjerë të ajrit, përfshirë NOx, CO dhe grimcat $PM_{2.5}$ e PM_{10}.

- Ofron potencialin për të kursyer rreth 250,000 fletë A4 në vit, ekuivalente me 1.25 tonë letër dhe afërsisht 20 - 30 pemë, si dhe për të shmangur rreth 1.4 tonë CO_2 e nga prodhimi i letrës, përmes digjitalizimit të hapjes së llogarive, kontratave, aplikimeve dhe dokumentacionit bankar.

- Shmang potencialisht rreth 52,000 kWh energji në vit për çdo degë tradicionale referuese që nuk nevojitet, duke reduktuar nevojat për ndriçim, ngrohje, ftohje dhe funksionimin e pajisjeve në ambiente, pa përfshirë konsumin e zyrave qendrore dhe sistemeve teknologjike.

BANKA OTP SHQIPËRI:

- Organizoi, në kuadër të nismës vullnetare Green Hearts, një marshim në Fushë-Studen, pjesë e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, për të promovuar potencialin turistik të destinacioneve më pak të njohura të Shqipërisë dhe për të nxitur eksplorimin e natyrës.

BANKA PROCREDIT SHQIPËRI:

- Organizoi, në bashkëpunim me Helvetas, Sida dhe CeProSARD, workshop-et "Green Finance", ku përfaqësues të BERZH prezantuan mundësitë për kështillim dhe financim të investimeve të gjelbra, me fokus te eficienca energjetike dhe përmirësimi i performancës mjedisore dhe ekonomike të bizneseve.
- Mori pjesë në panelin "National Ecosystem Opportunities", organizuar nga Green Building Council Albania (GBCA), ku u diskutuan mundësitë për efikasitet energjetik, financimin e gjelbër dhe investimet e qëndrueshme në Shqipëri.

BANKA RAIFFEISEN SHQIPËRI:

- Mbështet, në bashkëpunim me Korpusin Shqiptar të Vullnetarëve, nisma vullnetare për mbrojtjen e mjedisit, përmes aksioneve të pastrimit dhe aktiviteteve sensibilizuese në plazhe, parqe dhe zona të gjelbra.

TIRANA BANK:

- Mbështet tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët përmes financimit të projekteve të energjisë së rinovueshme, mobilitetit elektrik dhe eficiencës energjetike, duke nxitur përmes produkteve Green Finance dhe bashkëpunimit me BERZH investimet në teknologji efikase dhe zgjidhje të qëndrueshme energjetike.









DIMENSIONI EKONOMIK

Banka Intesa Sanpaolo Shqipëri:

- Rinovoi partneritetin me Fondacionin Shqiptar të Garancive për Zhvillim (ADGF), përmes një marrëveshjeje të re në kuadër të Mekanizmit të Garancisë KfW të BE-së për Ballkanin Perëndimor, me synim lehtësimin e aksesit në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, veçanërisht në zonat rurale, sektorin e prodhimit dhe sipërmarrjet e reja.

Jet Bank:

- Ofron mirëmbajtje llogarie, pagesa online dhe pagesa me kartë në POS pa komision, brenda dhe jashtë vendit, si dhe qasje tërësisht digjitale në shërbimet kryesore financiare, përfshirë hapjen e llogarive, kursimet, depozitat dhe aplikimet për kredi konsumatore.

Banka ProCredit Shqipëri:

- Nënshkroi marrëveshje me BERZH, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, për të zgjeruar financimin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri, përmes një garancie deri në 25 milionë euro, që mundëson kredi të reja deri në 50 milionë euro, me fokus te sipërmarrësit, bizneset e drejtuara nga gratë dhe të rinjtë, agrobiznesi dhe turizmi.
- Mbështeti nismën "WE Finance Code Albania", të lançuar nga Banka e Shqipërisë dhe BERZH, që synon të përmirësojë qasjen në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në pronësi ose të drejtuara nga gratë.
- Lançoi Kredinë Direct, një kredi konsumatore 100% online, që u mundëson klientëve të kryejnë të gjithë procesin, nga aplikimi dhe nënshkrimi digjital i dokumentacionit deri te disbursimi i shumës në llogarinë e tyre, pa vizituar degët e bankës.

Raiffeisen Bank Shqipëri:

- Rinovoi marrëveshjen e bashkëpunimit me Albanian Development Guarantee Foundation (ADGF), në kuadër të EU KfW Western Balkans Guarantee Facility, me synim zgjerimin e qasjes në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Partneriteti synon të mbështesë investimet, modernizimin e proceseve dhe adoptimin e teknologjive të reja nga bizneset, duke nxitur sipërmarrjen, rritjen e konkurrueshmërisë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Tirana Bank:

- Zgjeroi qasjen në shërbimet financiare përmes lançimit të onboarding-ut digjital, kredive tërësisht digjitale dhe integrimit të Apple Pay, Google Pay dhe pagesave SEPA, duke lehtësuar përdorimin e shërbimeve bankare nga qytetarët dhe bizneset.

Union Bank:

- Rinovoi marrëveshjen e bashkëpunimit me Agjencinë e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale për Kartën e Studentit, një produkt që kombinon kartën e debitit me përfitimet dhe zbritjet ekskluzive për studentët.









BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE (ABI):

- Mbështeti si sponsor koncertin e Zucchero World Tour, duke kontribuar në pasurimin e jetës kulturore dhe sjelljen e përvojave muzikore ndërkombëtare pranë publikut shqiptar.
- Financoi mobilimin e plotë të katit të parë të ambienteve të reja të Shkollës Speciale "Zëra Jete" në Elbasan, ku mësojnë mbi 50 nxënës.

BANKA CREDINS:


- Dhuroi, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, mjete shkollore për 100 fëmijë në vështirësi ekonomike, në ditën e parë të shkollës, për t'i ndihmuar të nisin vitin e ri shkollor me më shumë mundësi.
- Nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin Kanadez të Teknologjisë (CTI), për të krijuar mundësi punësimi dhe zhvillimi profesional për studentët përmes praktikave profesionale dhe punësimit në bankë.
- Mbështeti zhvillimin e Balkan Olympiad in Informatics 2026, ku 70 të rinj nga 18 vende dëshmuan njohuritë, kreativitetin dhe aftësitë e tyre në informatikë dhe logjikë.
- Mundësoi hapjen e ekspozitës "Deti dhe Muzika", kushtuar artistit Ibrahim Kodra, ku u prezantuan 41 vepra të koleksionit të piktorit, të krijuara në dekada të ndryshme.
- Organizoi në ambientet e Drejtorisë Qendrore ekspozitën "Një jetë në art", duke prezantuar 20 vepra të artistit Zaim Elezi, me tematika të ndryshme dhe ngjyra të veçanta.
- Zhvilloi projektin "Credins FunZone", në kuadër të mbështetjes së Kampionatit Botëror 2026, duke krijuar një skemë shpërblimi për klientët besnikë të bankës. Përmes aktiviteteve argëtuese, klientët patën mundësi të përfitonin edhe shpërblime monetare dhe dhurata.
- Zhvilloi sesione informuese mbi Inteligjencën Artificiale për stafin gjatë muajve korrik dhe gusht, me synim rritjen e njohurive mbi teknologjinë dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj klientëve.













- Mbështeti eventet verore Zamna Festival dhe DJ Mahmut Orhan, duke kontribuar në promovimin e muzikës elektronike dhe pasurimin e ofertës kulturore e argëtuese në jug të Shqipërisë.
- Organizoi ekspozitën "Udhëtim përmes kujtesës" në ambientet e Drejtorisë Qendrore, ku artisti Fatmir Tufina prezantoi 20 vepra në hollin e bankës.

BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHQIPËRI (FIBANK):

- Mori pjesë në podcastin "Business Plus" të Revista Monitor, ku u diskutuan ndikimi i masave të Bankës së Shqipërisë në kreditë për banesa dhe zhvillimet e sfidat e tregut të financimit të banesave në Shqipëri, për të rritur informimin mbi kushtet e kreditimit dhe rëndësinë e marrjes së vendimeve të informuara financiare.
- Përforcoi mbështetjen për sportet dimërore në Shqipëri, duke iu bashkuar një mbrëmjeje kushtuar arritjeve të sportistëve dhe kontributit të partnerëve, në kuadër të bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Skive.
- Sponsorizoi edicionin e parë të festivalit SINTRAK – Poezi dhe Koreografi Bashkëkohore, të zhvilluar në Tiranë më 17 - 19 shtator 2026, nën temën "KOHËSTREHIM". Festivali bashkoi poetë, shkrimtarë dhe artistë, duke promovuar forma të reja të shprehjes artistike.

BANKA INTESA SANPAOLO SHQIPËRI:

- Mundësoi pjesëmarrjen e fëmijëve të punonjësve në IBD Summer Camp 2026, një program 10-ditor në Marina di Massa, Itali, me aktivitete sportive, krijuese dhe edukative, që nxiti socializimin, shkëmbimin kulturor dhe krijimin e miqësive mes bashkëmoshatarëve nga vende të ndryshme.
- Siguroi pjesëmarrjen e punonjësve në takimin virtual të Klubit të Filmit të IBD-së, kushtuar filmit "Hidden Figures", duke nxitur diskutimin mbi diversitetin, vlerësimin e talenteve dhe bashkëpunimin me kolegë nga vende të ndryshme.
- Zhvilloi në kuadër të Grupit Intesa Sanpaolo dhe nismës TogetherIN, edicionin e tretë të Javës së Përfshirjes, me pesë aktivitete online mbi zhvillimin profesional, diversitetin, mirëqenien dhe inovacionin, duke promovuar një kulturë korporative gjithëpërfshirëse.
- Organizoi një aktivitet mbi ndikimin e jetëgjatësisë në shëndet, familje, financa dhe biznes, me pjesëmarrjen e ekspertëve të bankës, Deloitte Albania dhe Eurizon Capital, ku u diskutua mbi marrëdhëniet ndërmjet brezave, planifikimin financiar dhe përshtatjen e bizneseve e investimeve me sfidat e një jete më të gjatë.











JET BANK:

- Mbështet deri në tetor 2026, Fondacionin Down Syndrome Albania përmes një nisme donacionesh, ku për çdo transaksion me kartë, banka kontribuon me 10 lekë nga fondet e saj, pa kosto shtesë për klientët, duke ndihmuar fëmijët dhe familjet që përfitojnë nga shërbimet e fondacionit.



BANKA OTP SHQIPËRI:

- Dhuroi mjete shkollore për Fshatrat SOS Shqipëri në kuadër të vitit të ri shkollor 2026 - 2027, duke kontribuar në krijimin e kushteve më të mira për edukimin e fëmijëve dhe mundësive më të barabarta në arsim.
- Zhvilloi Programin Veror të Praktikës 2026, duke u ofruar studentëve dhe të sapo diplomuarve mundësinë të fitojnë përvojë praktike në sektorin bankar, të zhvillojnë aftësi profesionale dhe të njihen nga afër me funksionimin e bankës.
- Mbështeti, në bashkëpunim me Bashkinë Krujë, organizimin e koncertit të grupit Elita 5, duke kontribuar në gjallërimin e jetës kulturore lokale dhe promovimin e turizmit gjatë sezonit veror.
- Kontribuoi në festimin e Ditës Kombëtare të Francës, duke nxitur dialogun dhe shkëmbimin kulturor, si dhe forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.
- Promovoi artin bashkëkohor përmes mbështetjes së "Butrinti Summer Festival 2026", në bashkëpunim me Shoqatën "Ress Egnatia", për baletin modern "Romeo & Zhuliet", interpretuar nga trupa hungareze Noémi Kulcsár Tellabor, në skenën antike të Butrintit.





BANKA PROCREDIT SHQIPËRI:

- Shpërndau dhurata për nxënësit e disa shkollave 9-vjeçare në Shqipëri, në kuadër të nismës "Back to School me ProCredit", si dhe informoi mësuesit dhe nxënësit mbi produktet dhe shërbimet bankare, përfshirë mundësitë e kursimit dhe financimit.



RAIFFEISEN BANK SHQIPËRI:

- Zhvilloi programin e brendshëm 10-javor "Fridays for Innovation (FFI)", përmes workshopeve praktike, mentorimit dhe projekteve reale, duke nxitur zhvillimin e aftësive në inovacion, mendim kritik dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe forcimin e kulturës së të mësuarit dhe bashkëpunimit brenda bankës.
- Mbështeti përmes Raiffeisen Invest, në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastër, organizimin e "Natës Gjirokastrite 2026", duke promovuar trashëgiminë historike, vlerat kulturore dhe traditat e qytetit.
- Mbështeti, përmes Raiffeisen Invest, edicionin e vitit 2026 të KoKoFEST, festivalit të humorit dhe teatrit, të zhvilluar në Korçë nga 29 gushti deri më 6 shtator.
- Promovoi përmes Raiffeisen Invest dhe në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe, traditat dhe identitetin kulturor të Malësisë së Madhe nëpërmjet festivalit "Logu i Bjeshkëve 2026".
- Përkrahu, përmes Raiffeisen Invest, edicionin e gjashtë të "Dropull International Short Film Festival", duke sjellë së bashku krijues dhe artdashës dhe duke i dhënë hapësirë kinemasë shqiptare e rajonale, talenteve të reja dhe shkëmbimit kulturor.
- U angazhua, së bashku me Mastercard si partner Platinum, në rikthimin e Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar në Tiranë pas 13 vitesh mungesë, për edicionin e tij të 14-të, duke i kushtuar dhjetë ditë kinemasë shqiptare dhe duke afruar artistët, profesionistët e industrisë dhe publikun.
- Bashkëpunoi me Mastercard për organizimin e një mbrëmjeje muzikore në Tiranë, me performancat e Sono International dhe DJ ANOTR.
- Pajisi Spitalin e Librazhdit me një pajisje ECHO, përmes Raiffeisen Invest, duke ndihmuar në forcimin e kapaciteteve diagnostikuese dhe përmirësimin e qasjes së pacientëve në shërbime shëndetësore pranë komunitetit ku jetojnë.
- Siguroi, përmes Raiffeisen Invest, materiale mjekësore për Spitalin e Sarandës, duke ndihmuar në përmbushjen e nevojave të institucionit dhe në përmirësimin e kushteve për ofrimin e kujdesit shëndetësor për banorët dhe pushuesit gjatë sezonit turistik.
- Pasuroi fondin e Bibliotekës së Qytetit të Klosit me libra të rinj, përmes Raiffeisen Invest dhe në bashkëpunim me







Bashkinë Klos, duke nxitur leximin, edukimin dhe zhvillimin kulturor të komunitetit, veçanërisht tek të rinjtë.

- Kontribuoi përmes Raiffeisen Invest, në krijimin e një laboratori kompjuterik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike në Universitetin Politeknik të Tiranës, duke ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës akademike.
- Modernizoi përmes Raiffeisen Invest, mjedisin mësimor në shkollën 9-vjeçare "Islam Ibi" në Pogradec, duke e pajisur me mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT) për të lehtësuar integrimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe për të zgjeruar mundësitë e edukimit digjital për nxënësit dhe mësuesit.

TIRANA BANK:

- Kontribuoi në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore përmes nismave sociale dhe donacioneve për Spitalin Memorial Fier, Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Elbasan dhe Spitalin Rajonal Vlorë.
- Investoi në përmirësimin e kushteve të edukimit përmes pajisjes së Shkollës "Shefqet Sulejmani" në Sarandë me mjete pune dhe mbështetjes së Rezidencës Studentore Universitare, duke nxitur zhvillimin arsimor dhe profesional të të rinjve.
- Modernizoi infrastrukturën teknologjike përmes investimeve strategjike që mbështesin transformimin digjital, duke lançuar platformën TiBank+, Apple Pay, Google Pay, pagesat SEPA dhe integrimin me fintech-et, me synim përshpejtimin e zhvillimit të produkteve të reja dhe rritjen e fleksibilitetit operacional.









Jet Bank	Banka ProCredit Shqipëri	Union Bank Albania

U angazhuan në nismën “Dhuro gjak, shpëto jetë!”, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, duke kontribuar në mbështetjen e nevojave të shëndetit publik dhe të fëmijëve me talasemi.
Përmes pjesëmarrjes vullnetare së punonjësve në këtë nismë, bankat promovuan solidaritetin, humanizmin dhe përgjegjësinë sociale ndaj kauzave që kontribuojnë drejtpërdrejt në shpëtimin e jetëve.







Intesa Sanpaolo Bank Albania	**Banka ProCredit Shqipëri**	**Raiffeisen Bank Shqipëri**	**Union Bank**

U angazhuan në mbështetjen e fëmijëve të SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri përmes dhurimit të çantave, pakove dhe mjeteve shkollore në prag të fillimit të vitit të ri shkollor. Ky angazhim u realizua edhe në kuadër të fushatës "Çanta plot, Zemra plot!" dhe nismës "Kujdesemi me Zemër", duke ndihmuar në sigurimin e materialeve të nevojshme për mësim dhe në krijimin e kushteve më të mira për përgatitjen e fëmijëve për shkollë. Këto kontribute pasqyrojnë rëndësinë e bashkëpunimit me organizatat sociale për të mbështetur fëmijët në nevojë dhe për të nxitur mundësi më të barabarta në arsim.





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Broshurë 3-mujori i Tretë
Korrik-Shtator 2026

www.aab.al